



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborna komisija za žalbe i molbe

**A NR. 96-2/2010**

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Ymer Hoxha, anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit të pavarur Nevzat Hydaverdi nga Prishtina, paraqitur kundër vendimit të mëparshëm të KZAP-it A nr. 96 datë 18.03.2010, për rishqyrtim të vendimit, në seancën e panelit të mbajtur me 11.03.2010, mori këtë:

### **VENDIM**

Apeli për rishqyrtim refuzohet si i pabazuar

### **ARSYETIMI**

Kandidati i pavarur për këshilltar të asamblesë komunale z. Nevzat Hydaverdi nga Prishtina ka parashtruar ankesë me pretendim se Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim ka pas obligim që t'ja dërgoj formularin për publikimin e raportit financiar. Sipas parashtruesit të ankesës, ZRPPC-ja këtë obligim e ka bërë me datën 18.02.2010, prandaj parashtruesi i ankesës mëtej thekson se në vendimin e mëparshëm të KZAP-it A nr.96 datë 01.03.2010, në pasuesin e fakteve nuk është bere prezantimi i përgjigjes në ankesën e ZRPPC-s.

Parashtruesi i Apelit, propozon që të rishqyrtohet vendimi i marrë me datë 01.03.2010.

### **FAKTET**

Më 03.03.2010, KZAP-i ka pranuar një apel me shkrim nga kandidati i pavarur për këshilltar të asamblesë komunale z. Nevzat Hydaverdi i cili thekson se Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim ka pas për obligim me ia dërguar formularin për publikimin e raportit financiar. Parashtruesi i apelit mëtej thekson se në vendimin e mëparshëm të KZAP-it A nr.96 datës 01.03.2010, në pasuesin e fakteve nuk është bere prezantimi i përgjigjes në ankesën e ZRPPC-s.

Vendimi i KZAP-it ishte marrë në bazë të nenit 40.1 (Kërkesat për Deklarim Financiar) të LZP-së, përcakton se: *çdo subjekt politik i certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje, dorëzon Raportet e Deklarimit Financiar të Fushatës së Subjektit, duke i përfshirë të gjitha degët dhe pjesët*

*përbërëse të tij, për periudhën që fillon nëntëdhjetë (90) ditë para zgjedhjeve dhe me mbarim në ditën e zgjedhjeve. Raporti i Publikimit Financiar për Fushatën dorëzohet jo më vonë se dyzetë e pesë (45) ditë kalendarike pas ditës së zgjedhjeve.*

### **ANALIZË**

Juridiksioni i KZAP për shqyrtimin e ankesës buron nga kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP (Ligji nr – 03/073) dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligji nr 03/L-072).

Me rastin e pranimit të apelit kundër vendimit të KZAP-it, A nr.96 datë 01.03.2010 nga kandidati i pavarur për këshilltar të asamblesë komunale z. Nevzat Hydaverdi nga Prishtina, KZAP-i vlerëson se është vërtetë që nuk është theksuar në vendimin e mëparshëm A nr.96 datë 01.03.2010, përgjigjja në ankesën e ZRPPC-s, mirëpo KZAP-i konstaton se kjo nuk do të ndikonte në vendimmartje, ngase parashtruesi i përgjigjes në ankesën e ZRPPC-s nuk ia ka bashkangjitur asnjë fakt që të ketë ndikim në vendim. Në këtë kontekst, përgjigjja nga PDKI nuk konsiderohet si rrethanë lehtësuese, dhe se dorëzimi i Deklarimit të Raportit Financiar do të duhet të ndodhte brenda afatit ligjor

Duke u bazuar në nenin 118.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme i cili përcakton se: *KZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet.*

Prandaj, me rastin e apelit kundër vendimit të mëparshëm të KZAP-it, A nr. 96 datë 01.03.2010, i parashtruar nga kandidati i pavarur për këshilltar të asamblesë komunale z. Nevzat Hydaverdi nga Prishtina, i cili kërkon që të rishqyrtohet vendimi i KZAP-it A nr. 96 datë 01.03.2010 apeli për rishqyrtim refuzohet si i pabazuar.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa në Prishtinë**

A nr. 133/2010 më datën 18.03.2010

**Kryesuesi i Panelit**

**Muharrem Shala**

